

RELACION

PER PROJEKTLIGJIN "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 55/2015 "PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit "Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, është zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit "Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e vecantë", në zbatim të ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, edhe për 1 vit, pra deri më datën 31 dhjetor 2021.

Gjatë shqyrtimit vitin e kaluar, të projektligjit "Për një ndryshim të ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i cili gjithashtu pati për qëllim zgjatjen e afatit deri më 31 dhjetor 2020, u evidentua fakti se Ministria e Financave dhe Ekonomisë po punonte për hartimin e një projektligji të ri "Për investimet" dhe afati deri më 31 dhjetor 2020, do të ishte i mjaftueshëm për përfundimin e të gjitha procedurave ligjore të nevojshme për miratimin e këtij akti të ri.

Për fat të keq, për shkak të pandemisë së Covid 19, Qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i është dashur të mobilizojë të gjitha kapacitetet e saj, për gjetjen e mundësive sa më oportune, eficiente dhe efikase, për përballimin e pasojave të kësaj pandemie, element ky që ka kërkuar ndër të tjera edhe hartimin dhe sjelljen për miratim në Kuvend të një sërë paketash ligjore për rishikimin e Buxhetit të Shtetit por edhe të shumë politikave fiskale për lehtësimin e biznesit dhe përballimin e pasojave ekonomike të shkaktuara si pasojë e pandemisë. Në këtë kontekst, ka qënë e pamundur finalizimi i projektligjit të ri "Për investimet".

Në këto kushte për të shmangur krijimin e një boshllëku ligjor si dhe të pasojave që mund të krijohen prej tij, propozoj që afati i zbatimit të ligjit nr.55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të shtyhet deri më datë 31 dhjetor 2021.

Shtyrja edhe me një vit të këtij afati, (gjithnjë nëse nuk do të kemi situata të tjera të rënduara apo të paparashikuara për shkak të pandemisë) besoj se do të japë mundësinë Qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për

finalizimin e projektligjit të ri si dhe më pas përfundimin e procedurave të nevojshme për miratimin e tij dhe hyrjen në fuqi.

II. PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT:

Projektligji i propozuar përbëhet nga 2 nene gjithsej

- Neni 1, i projektligjit, ka përcaktuar që në nenin 36, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, fjalët "data 31 dhjetor 2020" të zëvendësohen me fjalët "data 31 dhjetor 2021".
- Neni 2, i projektligjit, ka përcaktuar hyrjen në fuqi 15 pas botimit në Fletoren Zyrtare, të projektligjit duke prezumuar se ka kohë të pjaftueshme për hyrjen e tij në fuqi deri më 1 janar 2021.

III. EFEKTET FINANCIARE

Zbatimi i këtij projektligji nuk ndikon dhe nuk kërkon fonde shtesë nga Buxheti i Shtetit.

IV. INSTITUCIONET ZBATUESE

Zbatimi i këtij projektligji do të vijojë të bëhet nga AIDA, Komiteti i Investimeve Strategjike, si dhe institucionet dhe organet e tjera të administratës shtetërore, sipas discrecionit të tyre institucional.